ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:

Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

ii/c. Organizimi dhe Staf: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit të tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:**Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si

më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

(a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

(b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE):
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	ç mimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Analiza e struktures dhe proceve te punes	1			
2.	Implmentimi I sistemit te proceve te punes	1			
3.	Trajnimi I perdoruesve	2 javë			
4	Mirembajtja e sistemit	24 muaj			
	Çmimi total				_____

		-
Çmimi Neto pa TVSH		
TVSH (%)		
Çmimi total me TVSH:		
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik]

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.

Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike

1. PËRFITUESI / AUTORITETI KONTRAKTUES

Përfituesi / Autoriteti kontraktor është Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. ose (“U.K.T”) SH.A.

2. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Institucioni "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sh.a. (UKT) synon të transformojë dhe të modernizojë mënyrën se si menaxhohen dokumentet dhe proceset e komunikimit të brendshëm. Qëllimi kryesor është implementimi i një *Sistemi të Integruar Elektronik* për menaxhimin e dokumentave dhe proceseve të punës, i cili do të mundësojë:

- **Digjitalizimin e plotë të dokumenteve:** Kalimi nga menaxhimi tradicional i dokumenteve në letër drejt një sistemi plotësisht elektronik, duke reduktuar kështu përdorimin e letrës, kostot operative dhe ndikimin mjedisor.
- **Rritjen e eficiencës operacionale:** Automatizimi i proceseve administrative dhe shkresore do të ulë kohën e nevojshme për përpunimin dhe shpërndarjen e dokumenteve, duke përmirësuar produktivitetin e stafit dhe shërbimin ndaj qytetarëve.
- **Përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe transparencës:** Sistemi do të lejojë gjurmimin në kohë reale të çdo dokumenti, duke siguruar transparencë të plotë në proceset vendimmarrëse dhe duke mundësuar auditime efektive.
- **Integrimin me sistemet ekzistuese:** Zgjidhja e re do të jetë në përputhje dhe do të integrohet me sistemet ekzistuese të institucionit, siç janë sistemet financiare, ato të burimeve njerëzore dhe sistemet e tjera operacionale, duke krijuar një ekosistem të unifikuar të menaxhimit të informacionit.
- **Përputhshmëria me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare:** Sistemi do të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.945, datë 02.11.2012, dhe do të respektojë standardet ndërkombëtare si ISO 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit.
- **Sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave:** Implementimi i masave të avancuara të sigurisë kibernetike për të mbrojtur të dhënat sensitive të institucionit dhe për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit.
- **Skalueshmëria dhe fleksibiliteti:** Zgjidhja do të projektohet me një arkitekturë të hapur që mundëson zgjerimin e kapaciteteve dhe funksionaliteteve në të ardhmen, në përputhje me nevojat në rritje të institucionit.
- **Mbështetjen e vendimmarrjes së informuar:** Përmes moduleve analitike dhe raporteve të avancuara, sistemi do të ofrojë informacion të vlefshëm për menaxhimin, duke lehtësuar vendimmarrjen strategjike dhe operacionale.

- **Përmirësimin e bashkëpunimit të brendshëm:** Facilitetet për punë në grup, ndarja e informacionit dhe komunikimi i integruar do të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet departamenteve dhe ekipeve të ndryshme brenda institucionit.
- **Përshtatjen me teknologjitë e reja:** Adoptimi i teknologjive moderne si inteligjenca artificiale për klasifikimin automatik të dokumenteve, shërbimet cloud për ruajtje dhe akses të sigurt nga çdo vendndodhje, dhe ndërfaqet miqësore për përdoruesit.

Pritshmëritë dhe përfitimeve nga ky sistemi përfshijnë:

- **Reduktim të kohës së procesimit:** Ulje deri në 50% e kohës së nevojshme për përpunimin dhe miratimin e dokumenteve, duke përshpejtuar kështu ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe partnerëve.
- **Rritje të saktësisë dhe eliminim të gabimeve:** Automatizimi i proceseve do të zvogëlojë gabimet njerëzore, duke përmirësuar cilësinë e të dhënave dhe vendimmarrjes.
- **Transparencë dhe përgjegjshmëri më të lartë:** Sistemi do të ofrojë gjurmueshmëri të plotë të veprimeve të kryera, duke rritur përgjegjshmërinë individuale dhe institucionale.
- **Përshtatshmëri me mevojat në ndryshim:** Fleksibiliteti i sistemit do të lejojë përshtatjen e shpejtë me ndryshimet ligjore, rregullative apo operacionale që mund të ndodhin në të ardhmen.

3. OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objekti kryesor i këtij shërbimi është zhvillimi dhe implementimi i një sistemi elektronik të avancuar, i cili përfshin të gjithë komponentët e nevojshëm për të siguruar funksionimin e pandërprerë (vazhdueshmërinë e punës në 99%) dhe për të plotësuar të gjitha kërkesat funksionale dhe teknike të institucionit. Ky sistem do të shërbejë si një platformë qendrore për menaxhimin e dokumenteve elektronike, proceseve të punës dhe komunikimit shkresor brenda institucionit.

KOMPONENTËT KRYESORË TË SISTEMIT JANË:

I. Komponenti i krijimit dhe menaxhimit të dokumentit elektronik

Ky komponent do të ofrojë funksionalitete të plota për krijimin, modifikimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve në formë elektronike. Karakteristikat kryesore përfshijnë:

- **Editor Dokumentesh të Integruar:** Mundësi për krijimin dhe redaktimin e dokumenteve brenda sistemit, me mbështetje për formate të ndryshme (p.sh., PDF, DOCX).
- **Versionimi i Dokumenteve:** Ruajtja e historisë së ndryshimeve, me mundësi rikthimi në versione të mëparshme.
- **Klasifikimi dhe Indeksimi:** Përcaktimi i metadatave, etiketimeve dhe kategorive për lehtësimin e kërkimit dhe organizimit të dokumenteve.

- **Nënshkrimi Elektronik dhe Vula Elektronike:** Integrimi me sisteme të nënshkrimit elektronik për të siguruar autenticitetin dhe integritetin e dokumenteve.
- **Politikat e Retencionit:** Përcaktimi i rregullave për ruajtjen dhe asgjësimin e dokumenteve sipas kërkesave ligjore dhe rregullative.

II. Identifikimi dhe menaxhimi i proceseve.

Ky komponent do të sigurojë automatizimin dhe monitorimin e proceseve të punës (workflows) brenda institucionit, duke përfshirë:

- **Modelimi i Proceseve të Punës:** Mjete për dizajnimin dhe konfigurimin e rrjedhëve të punës sipas nevojave specifike të departamenteve të ndryshme.
- **Menaxhimi i Afateve dhe Përkujtuesve:** Përcaktimi i afateve kohore për çdo detyrë ose proces, me alarmet dhe njoftimet përkatëse për të siguruar respektimin e tyre.
- **Ndjekja e Statusit në Kohë Reale:** Monitorimi i progresit të detyrave dhe proceseve, me raporte të detajuara mbi përmbushjen e tyre.
- **Rregullat e Biznesit dhe Kushtet e Vendosura:** Mundësia për të përcaktuar kushte specifike që drejtojnë rrjedhën e proceseve në bazë të skenarëve të ndryshëm.

III. Komponenti i menaxhimit të përdoruesve dhe të drejtave të tyre

Ky komponent është thelbësor për sigurimin e aksesit të kontrolluar dhe mbrojtjen e të dhënave, duke ofruar:

- **Autentifikimi dhe Autorizimi i Avancuar:** Autentifikim të centralizuar, me mbështetje për mekanizma shtesë si Multi-Factor Authentication (MFA).
- **Menaxhimi i Roleve dhe Grupeve:** Përcaktimi i roleve të ndryshme (p.sh., administrator, përdorues i thjeshtë, menaxher) dhe caktimi i të drejtave të aksesit sipas politikave të institucionit.
- **Kontrulli i Detajuar i Aksesit:** Mundësi për të caktuar të drejta specifike në nivel dokumenti, dosjeje ose funksionaliteti.
- **Auditimi i Aktivitetit të Përdoruesve:** Regjistrimi i veprimeve të kryera nga përdoruesit, për të siguruar gjurmueshmëri dhe për të përmbushur kërkesat e auditimit.

IV. Komponenti i gjenerimit të statistikave dhe raporteve

Ky komponent do të lehtësojë vendimmarrjen e informuar dhe monitorimin e performancës së sistemit dhe proceseve, duke përfshirë:

- **Raportime të Paracaktuara dhe të Personalizuara:** Një sërë raportesh standarde mbi përdorimin e sistemit, efikasitetin e proceseve, dhe performancën e departamenteve.
- **Analitikë e Avancuar:** Mjete për analizën e të dhënave në kohë reale, me mundësi vizualizimi përmes grafikëve dhe tabelave interaktive.
- **Eksportimi i të Dhënave:** Mundësi për të eksportuar raportet dhe të dhënat në formate të ndryshme (p.sh., Excel, PDF) për analiza të mëtejshme.

- **Alarmet dhe Njoftimet Bazuar në KPI-të:** Përcaktimi i indikatorëve kryesorë të performancës dhe marrja e njoftimeve kur ato tejkalohen ose nuk arrihen.

V. Komponenti i Administrimit të Sistemit

Ky komponent do të sigurojë menaxhimin e përgjithshëm të sistemit, përfshirë:

- **Konfigurimi i Parametrave të Sistemit:** Mundësi për të përshtatur parametrat operativë sipas nevojave të institucionit.
- **Menaxhimi i Sigurisë dhe Politikave të Aksesit:** Përcaktimi i politikave të fjalëkalimeve, seancave të përdoruesve, dhe rregullave të sigurisë.
- **Monitorimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit:** Mjete për monitorimin e performancës së sistemit, gjëndjes së serverave, dhe shërbimeve të tjera kritike.
- **Backup dhe Rikuperim i të Dhënave:** Implementimi i strategjive për kopje rezervë dhe rikuperim në rast emergjencash, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit.
- **Integrimi me Sisteme të Tjera:** Mjete dhe API për integrimin me aplikacione dhe sisteme të tjera brenda institucionit ose me palë të treta.

Përshkrim i Detajuar i Objekteve të Shërbimit:

1. Zhvillimi i Sistemit të Personalizuar:

- *Analiza e Kërkesave:* Kryerja e një analize të hollësishme për të kuptuar kërkesat funksionale dhe jofunksionale të institucionit.
- *Dizajni Arkitekturor:* Projektimi i arkitekturës së sistemit, duke marrë parasysh skalueshmërinë, performancën dhe sigurinë.
- *Zhvillimi Modular:* Implementimi i sistemit në module të pavarura por të integruara, për të lehtësuar mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ardhshëm.

2. Sigurimi i Vazhdueshmërisë së Punës në 99%:

- *Redundanca dhe Disponueshmëria e Lartë:* Implementimi i mekanizmave të redundancës në nivel hardueri dhe softueri për të minimizuar ndërprerjet.
- *Monitorimi 24/7:* Përdorimi i mjeteve të monitorimit të vazhdueshëm për të identifikuar dhe adresuar problemet në kohë reale.
- *Protokollet e Rikuperimit të Shpejtë:* Përcaktimi i procedurave të detajuara për rikuperimin e shërbimeve në rast të dështimeve.

3. Trajnimi dhe Transferimi i Njohurive:

- *Manualet e Përdoruesit dhe Dokumentacioni Teknik:* Ofrimi i materialeve të detajuara për përdoruesit fundorë dhe stafin teknik.
- *Sesione Trajnimi:* Organizimi i trajnimeve praktike për përdoruesit dhe administratorët e sistemit.

4. Mbështetja dhe Mirëmbajtja Teknike:

- *Mbështetje Teknike Pas Implementimit:* Ofrimi i shërbimeve të asistencës teknike për një periudhë të përcaktuar pas dorëzimit të sistemit.

- *Përditësime dhe Përmirësime Periodike*: Sigurimi i përditësimeve të rregullta për sistemin, duke përfshirë patch-e sigurie dhe funksionalitete të reja.

5. Përputhshmëria me Standardet dhe Legjislacionin:

- Respektimi i Kërkesave Ligjore: Sigurimi që sistemi është në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret relevante, duke përfshirë ato për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Certifikimet dhe Standardet Ndërkombëtare: Implementimi në përputhje me standarde si ISO 27001 (Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit) dhe ISO 9001 (Menaxhimi i Cilësisë).

4. AFATI I SHËRBIMIT

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë totale prej 5 (pesë) muajsh, gjatë së cilës do të realizohet zhvillimi, implementimi, testimi dhe dorëzimi i sistemit elektronik të menaxhimit të dokumenteve dhe proceseve të punës. Ky afat kohor është përcaktuar për të siguruar një balancë optimale midis cilësisë së punës dhe shpejtësisë së dorëzimit, duke garantuar përmbushjen e të gjitha kërkesave funksionale dhe teknike të institucionit.

Plani i Detajuar i Afatit Kohor:

Muaji 1: Analiza e Kërkesave dhe Projektimi i Sistemit

- Mbledhja e Kërkesave
- Dokumentimi i Specifikimeve Funksionale dhe Jofunksionale
- Projektimi i Arkitekturës së Sistemit
- Planifikimi i Projektit

Muaji 2 dhe 3: Zhvillimi dhe Implementimi

- Zhvillimi i Komponentit të Krijimit dhe Menaxhimit të Dokumentit Elektronik
- Zhvillimi i Komponentit të Menaxhimit të Përdoruesve dhe Të Drejtave të Tyre
- Zhvillimi i Komponentit të Menaxhimit të Proceseve dhe Afateve
- Zhvillimi i Komponentit të Gjenerimit të Statistikave dhe Raporteve
- Zhvillimi i Komponentit të Administrimit të Sistemit
- Integrimi me Sistemet Ekzistuese

Muaji 4: Testimi dhe Sigurimi i Cilësisë

- Testimi i Njësive (Unit Testing)
- Testimi i Integritetit
- Testimi i Sistemit
- Testimi i Performancës dhe Skalueshmërisë:
- Testimi i Sigurisë
- Korrektimi i Gabimeve

Muaji 5: Trajnimi, Implementimi dhe Dorëzimi Final

- Trajnimi i Përdoruesve
- Përgatitja e Dokumentacionit
- Migrimi i të Dhënave
- Implementimi në Prodhim
- Monitorimi Pas Implementimit
- Dorëzimi Përfundimtar dhe Miratimi

Aktivite Mbështetëse Gjatë Gjithë Periudhës:

- *Menaxhimi i Projektit:* Koordinimi i aktiviteteve, menaxhimi i burimeve dhe komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara.
- *Menaxhimi i Rreziqeve:* Identifikimi i rreziqeve potenciale.
- *Raportimi Periodik:* Ofrimi i raporteve javore dhe mujore mbi progresin e projektit.

5. PËRMBAJTJA E SISTEMIT

5.1 Përshkrim i Përgjithshëm

Sistemi elektronik i menaxhimit të proceseve të punës do të përmbushë të gjitha nevojat për një aplikacion të avancuar të menaxhimit të përmbajtjes dhe dokumenteve, duke përdorur teknologjitë më të fundit në fushën e menaxhimit të detyrave administrative.

Sistemi do të bazohet në tre koncepte bazë:

- **Bashkëpunimi:** Mjete bashkëpunuese që lejojnë përdoruesit e shumëfishtë të punojnë në të njëjtën përmbajtje në një mjedis të përbashkët, me mundësi për komente, versionim dhe ndarje të informacionit në kohë reale.
- **Menaxhimi i Ciklit Jetësor të Dokumenteve:** Mjete për menaxhimin e ciklit jetësor të përmbajtjes së informacionit të institucionit, nga krijimi, indeksimi dhe menaxhimi i tyre deri në arkivim dhe asgjësim, sipas politikave të përcaktuara.
- **Menaxhimi i Dokumenteve Elektronike:** Mjete që monitorojnë dhe menaxhojnë dokumentet në institucion, duke përfshirë indeksimin e përmbajtjes së dokumenteve, autorizimin, krijimin e flukseve të punës (workflows), arkivimin e dokumenteve dhe sistemet e rikthimit të informacionit nëpërmjet versionimit të dokumenteve.

Sistemi elektronik do të implementohet për menaxhimin e dokumenteve elektronike dhe procesit të trajtimit të tyre në institucion. Ai do të shërbejë për rritjen e cilësisë së përgjithshme në procesimin e shkresave, duke ofruar ndjekje në kohë reale të dokumenteve për të zvogëluar vonesat apo pengesat e ndryshme në proces.

Funksionalitetet kryesore të sistemit janë:

- a) Digjitalizimi dhe ndjekja e procesit të shkresave hyrëse dhe dalëse në institucion.
- b) Rritja e eficiencës përmes detajimit të afateve dhe formalizimit të procesit.
- c) Përmirësimi i performancës, produktivitetit dhe eficiencës operacionale të

administratës.

- d) Përmirësimi i monitorimit dhe rritja e eficiencës së administrimit të kërkesave.
- e) Përmirësimi dhe garantimi i transparencës.
- f) Monitorimi i aktivitetit të institucionit sipas objektivave të vendosura.
- g) Të gjithë përdoruesit e sistemit janë punonjës të administratës së institucionit.

5.2 Analiza e Proceseve të Punës

5.2.1 Identifikimi në Sistem

- **Integrimi dhe Autentifikimi i Avancuar:** Sistemi do të siguroj autentifikim të centralizuar dhe menaxhim të unifikuar të identiteteve. Do të mbështetet autentifikimi me shumë faktorë (MFA), duke përfshirë përdorimin e token-eve softuerike/harduerike, biometrisë ose SMS, për të rritur sigurinë.
- **Menaxhimi i Detajuar i Roleve dhe Grupeve:** Do të krijohen role të përcaktuara qartë, me nivele të ndryshme të aksesit dhe privilegjeve. Kjo do të lejojë kontroll të detajuar mbi atë që çdo përdorues mund të shohë dhe të bëjë në sistem, bazuar në përgjegjësitë dhe funksionet e tyre.
- **Politikat e Sigurisë dhe Aksesit:** Implementimi i politikave të avancuara të sigurisë, si politika të kompleksitetit të fjalëkalimeve, kufizimet e kohës së aksesit dhe vendndodhjes, si dhe detektimi i sjelljeve anormale.
- **Auditimi i Aktivitetit dhe Gjurmueshmëria:** Regjistrim i detajuar i të gjitha veprimeve të kryera nga përdoruesit, duke përfshirë hyrjet, modifikimet, aprovimet dhe aksesin në dokumente. Kjo do të mundësojë gjurmueshmëri të plotë dhe do të ndihmojë në përmbushjen e kërkesave të auditimit dhe përputhshmërisë.

5.2.2. Menaxhimi i Dokumenteve Elektronike

- **Krijimi dhe Redaktimi i Dokumenteve:** Sistemi do të ofrojë një editor të integruar të dokumenteve, me funksionalitete të avancuara për krijimin, redaktimin dhe formatimin e dokumenteve brenda platformës. Mbështetje për formate të ndryshme dokumentesh si DOCX, PDF, XLSX, etj.
- **Versionimi dhe Klasifikimi i Dokumenteve:** Çdo ndryshim i bërë në dokumente do të ruhet si një version i veçantë, duke lejuar rikthimin në versione të mëparshme dhe ndjekjen e historikut të modifikimeve. Dokumentet do të klasifikohen sipas metadave të përcaktuara, si p.sh., kategoria, departamenti, autori, data e krijimit, etj.
- **Arkivimi dhe Politikat e Retencionit:** Përcaktimi i politikave të ruajtjes dhe asgjësimit të dokumenteve, bazuar në kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme. Implementimi i një sistemi të arkivimit elektronik që përputhet me standardet e arkivave.
- **Kërkimi i Avancuar dhe Indeksimi:** Mjete të fuqishme për kërkimin e dokumenteve bazuar në përmbajtje, metadata ose atributet e tjera.

5.2.3. Menaxhimi i Flukseve të Punës (Workflow)

- **Dizajnues Vizual i Flukseve:** Një mjet intuitiv për krijimin dhe modifikimin e flukseve të punës, me ndërfaqe grafike "drag-and-drop", që lejon modelimin e proceseve të biznesit pa nevojën për kodim.
- **Automatizimi i Proceseve:** Përcaktimi i rregullave dhe kushteve që drejtojnë rrjedhën e punës, duke përfshirë kushte, degëzime, cikle aprovimi dhe njoftime automatike.
- **Monitorimi dhe Eskalimi i Flukseve:** Ndjekja në kohë reale e progresit të flukseve të punës, me mundësi për eskalim automatik të detyrave të vonuara ose të paaprovuara brenda afateve të përcaktuara.

5.2.4. Menaxhimi i Detyrave dhe Projekteve

- **Caktimi dhe Menaxhimi i Detyrave:** Mundësia për të caktuar detyra individuale ose ekipe, me afate, prioritet dhe përshkrime të detajuara.
- **Ndjekja e Progresit dhe Raportimi:** Përdoruesit mund të raportojnë progresin e detyrave të tyre, të bashkëngjisin dokumente ose komente, dhe të kërkojnë ndihmë ose aprovime.
- **Integrimi me Kalendarët dhe Njoftimet:** Sinkronizimi me kalendarët personalë (p.sh., Outlook, Google Calendar) dhe dërgimi i njoftimeve me email, SMS ose brenda platformës.

5.2.5. Menaxhimi i Performancës dhe Raportimi

- **Dashborde të Personalizuara:** Panelë vizualë që shfaqin informacionet kryesore për përdoruesin, si detyrat e hapura, afatet e ardhshme, statistikën e performancës, etj.
- **Raportime Analitike dhe BI:** Gjenerimi i raporteve të detajuara dhe analitika e avancuar për të vlerësuar performancën e departamenteve, ekipeve ose individëve.
- **Indikatorët Kryesorë të Performancës (KPI):** Përcaktimi dhe monitorimi i KPI-ve të ndryshme, si koha mesatare e përpunimit të dokumenteve, numri i detyrave të përfunduara, saktësia e të dhënave, etj.
- **Alarmet dhe Njoftimet Bazuar në Performancë:** Konfigurimi i alarmeve automatike kur indikatorët e caktuar tejkalojnë pragjet e përcaktuara, duke lejuar ndërhyrje të shpejta menaxheriale.

5.2.6. Integrimi me Sisteme të Tjera

- **API të Hapura dhe Microservices:** Ofrimi i API-ve RESTful të dokumentuara mirë për integrim me aplikacione të tjera të brendshme ose të palëve të treta.
- **Sinkronizimi i Të Dhënave dhe ETL:** Implementimi i proceseve të Ekstraktimit, Transformimit dhe Ngarkimit (ETL) për sinkronizimin e të dhënave ndërmjet sistemeve.
- **Integrimi me Sistemet Financiare dhe HR:** Ndërlidhja me sistemet ekzistuese të financave, kontabilitetit, burimeve njerëzore, dhe ERP, për një menaxhim të unifikuar të informacionit dhe evitimin e duplikimit të të dhënave.

- **Single Sign-On (SSO):** Implementimi i mekanizmave të SSO për një eksperiencë të unifikuar të autentifikimit në të gjitha aplikacionet.

5.2.7. Siguria dhe Përputhshmëria

- **Enkriptimi i Të Dhënave:** Enkriptimi i të dhënave në tranzit (p.sh., SSL/TLS) dhe në pushim (p.sh., AES-256) për të mbrojtur konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit.
- **Menaxhimi i Çelësve Kriptografikë:** Përdorimi i shërbimeve të menaxhuara për çelësa kriptografikë (KMS) për menaxhimin e sigurt të çelësve të enkriptimit.
- **Zbulimi dhe Parandalimi i Kërcënimeve:** Implementimi i sistemeve të zbulimit të ndërhyrjeve (IDS) dhe parandalimit të ndërhyrjeve (IPS), si dhe shërbimeve të avancuara të sigurisë.
- **Përputhshmëria me Standardet dhe Rregulloret:** Sigurimi që sistemi është në përputhje me ligjet dhe rregulloret relevante, si GDPR për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe standardet ISO 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

5.2.8. Menaxhimi i Komunikimit dhe Bashkëpunimit

- **Komunikim i Integruar:** Funkcionalitete për komunikim të brendshëm ndërmjet përdoruesve, duke përfshirë mesazhe të drejtpërdrejta, diskutime grupi dhe forume.
- **Ndarja e Dokumenteve dhe Bashkëpunimi në Kohë Reale:** Mundësia për bashkëpunim në dokumente në kohë reale, me redaktim të njëkohshëm nga përdorues të ndryshëm.
- **Kalendari dhe Planifikimi i Ngjarjeve:** Planifikimi i takimeve, eventeve dhe aktiviteteve të tjera, me sinkronizim me kalendaret personale.
- **Integrimi me Mjetet e Komunikimit:** Ndërlidhja me platforma si Microsoft Teams, Slack ose ekuivalente, për një komunikim më efikas.

5.2.9. Menaxhimi i Riskut dhe Konformitetit

- **Identifikimi dhe Vlerësimi i Riskut:** Mjete për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve operacionale, të sigurisë dhe konformitetit.
- **Kontrollet dhe Politikat e Konformitetit:** Implementimi i kontrolleve të brendshme dhe politikave për të siguruar përputhshmëri me kërkesat rregullatore dhe standardet e industrisë.
- **Auditimi dhe Raportimi i Konformitetit:** Gjenerimi i raporteve dhe evidencave të nevojshme për auditime të brendshme dhe të jashtme.

5.2.10. Menaxhimi i Shërbimit dhe Mbështetjes

- **Help Desk i Integruar:** Mjete për menaxhimin e kërkesave për mbështetje, incidenteve dhe problemeve teknike nga përdoruesit.
- **Baza e Njohurive:** Krijimi i një baze të centralizuar të njohurive me udhëzime, tutoriale dhe FAQ për përdoruesit.

- **Monitorimi i Shërbimit dhe SLA:** Ndjekja e performancës së shërbimit sipas Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit (SLA), me raportim të detajuar.


5.2.11. Menaxhimi i Dokumentacionit Teknik dhe Standardeve

- **Biblioteka e Dokumenteve Teknike:** Ruajtja dhe menaxhimi i dokumentacionit teknik, manualeve, standardeve dhe procedurave operative.
- **Kontrolli i Versioneve dhe Aprovimeve:** Sigurimi që dokumentet teknike kalojnë nëpër procese të aprovimit dhe janë të versionuara saktë.
- **Kërkimi i Avancuar në Dokumentacion:** Mjete për kërkim të shpejtë dhe efikas në dokumentacionin teknik bazuar në fjalë kyçe, fraza ose metadata.

5.2.12. Arkitektura e Sistemit dhe Teknologjitë e Përdorura

- **Arkitektura Microservices:** Sistemi do të bazohet në një arkitekturë microservices, duke lejuar modularitet, shkallëzim dhe mirëmbajtje më të lehtë.
- **Shërbimet Cloud:** Përdorimi i shërbimeve cloud si AWS , Azure ose ekuivalente.
- **Kontejnerizimi dhe Orkestrimi:** Përdorimi i Docker për paketimin e aplikacioneve dhe Kubernetes për orkestrimin e konteinerëve, duke siguruar shkallëzim dhe disponueshmëri të lartë.
- **Bazat e të Dhënave të Shkallëzueshme:** Përdorimi i bazave të të dhënave relacionale për ruajtjen e të dhënave strukturuar dhe jo-strukturuar.

Procesi i menaxhimit të dokumentit elektronik do të implementohet në sistem sipas një skeme të përcaktuar, e cila do të përshkruajë rrjedhën e punës nga krijimi deri te arkivimi i dokumenteve. Kjo skemë do të jetë e parametrizueshme, duke lejuar përshtatjen e proceseve sipas nevojave të institucionit.



Sistemi do të ketë konceptin e "**Zyrës**", e cila është njësi organizative e drejtorive dhe sektorëve. Zyrat do të konceptohen si grupe, ku për çdo grup do të krijohen të drejta të personalizuar. Këto të drejta mund të menaxhohen nga administratori i sistemit nëpërmjet ndërfaqes së menaxhimit të të drejtave.

Për çdo zyrë, do të veprojnë dy role kryesore:

- **Roli Drejtor:** Mund të shohë të gjitha detyrat që i caktohen zyrës dhe mund t'i shpërndajë ato tek specialistët, si dhe të redaktojë dhe miratojë punën e tyre.
- **Roli Specialist:** I shfaqet detyra e caktuar nga drejtori tek "Detyrat e Mia", dhe mund të kryejë veprimet e nevojshme sipas autorizimeve të dhëna.

Procesi i trajtimit të shkresave:

- **Shkresa Hyrëse:**
 - Regjistrimi dhe skanimi i dokumenteve në zyrën e Protokollit.
 - Caktimi i shkresave për informim dhe kompetencë tek përdoruesit përkatës.
 - Delegimi i shkresave në zyrat përkatëse për trajtim.
- **Shkresa Dalëse:**
 - Përgatitja dhe firmosja e dokumentit nga specialistët dhe drejtuesit.
 - Regjistrimi i protokollit dalës në zyrën e Protokollit.
 - Skanimi dhe arkivimi i dokumentit dalës.

Pasi shkresa përfundon përpunimin dhe merr aprovimet e nevojshme, ajo do të dërgohet në zyrën e Protokollit për t'u protokolluar dhe, nëse është e nevojshme, do të kalojë në arkivë.

- Marrja e dokumentit të përgatitur dhe firmosur.
- Regjistrimi i protokollit dalës.
- Modifikimi i regjistrimit të protokollit.
- Skanimi i dokumentit dalës.

5.1 Skema Logjike

Sistemi do të konceptohet në një arkitekturë me shumë shtresa (multi-tier), duke përfshirë:

- **Shtresa e Prezantimit (Front-end):** Ndërfaqja e përdoruesit e bazuar në teknologji moderne si React, Angular ose Vue.js, që ofron një eksperiencë të pasur dhe interaktive.
- **Shtresa e Shërbimeve të Aplikacionit (Back-end):** Shërbimet e aplikacionit të shkruara në gjuhë programimi si Java, .NET Core, Python ose Node.js, që trajtojnë logjikën e biznesit dhe ndërveprimet me bazën e të dhënave.
- **Shtresa e Integritit dhe API-ve:** Një shtresë e dedikuar për API-të dhe shërbimet e integritit me sisteme të tjera, duke përdorur standarde si RESTful API, gRPC ose GraphQL.
- **Shtresa e Të Dhënave:** Bazat e të dhënave relacionale dhe NoSQL, sisteme të cache-it (p.sh., Redis), dhe shërbime të ruajtjes së dokumenteve.

- **Shtresa e Sigurisë:** Komponentë që sigurojnë autentifikimin, autorizimin, enkriptimin dhe mbrojtjen kundër sulmeve të ndryshme.
- **Shtresa e Monitorimit dhe Logimit:** Mjete për monitorimin e performancës, logimin e ngjarjeve dhe analizën e sistemit.

5.2 Infrastruktura mbështetëse

Sistemi do të jetë i hostuar në një mjedis cloud të sigurt dhe të shkallëzueshëm, duke siguruar disponueshmëri të lartë, performancë të qëndrueshme dhe fleksibilitet në zgjerim.

Karakteristikat kryesore të infrastrukturës mbështetëse janë:

- **Shërbimet Cloud:**
 - **Compute Services:** Përdorimi i instancave virtuale për ekzekutimin e aplikacionit, me mundësi për auto-skalim bazuar në ngarkesën e punës.
 - **Storage Services:** Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave në shërbime të sigurta dhe të qëndrueshme me enkriptim të të dhënave.
 - **Database Services:** Përdorimi i bazave të të dhënave të menaxhuara.
 - **Networking Services:** Konfigurimi i rrjeteve virtuale private (VPC), kontrolli i trafikut dhe sigurimi i komunikimit të sigurt.
- **Disponueshmëria dhe Redundanca:**
 - Implementimi i sistemeve të disponueshmërisë së lartë (High Availability) dhe balancuesve të ngarkesës (Load Balancers) për të siguruar funksionimin e pandërprerë të sistemit.
 - Përdorimi i zonave të disponueshmërisë së shumta (Availability Zones) për të minimizuar ndikimin e dështimeve lokale.
- **Skalueshmëria Automatikë:**
 - Konfigurimi i auto-skalimit (Auto Scaling) për të shtuar ose hequr burime në mënyrë automatike bazuar në metrikat e performancës dhe kërkesat e sistemit.
- **Siguria e Avancuar:**
 - Përdorimi i shërbimeve si Access Management për menaxhimin e detajuar të aksesit.
 - Implementimi i firewall-eve aplikative (WAF) dhe monitorimit të trafikut për të mbrojtur kundër sulmeve kibernetike.
 - Enkriptimi i të dhënave në pushim dhe në tranzit duke përdorur protokolle të sigurta si SSL/TLS.
- **Integrimi me Shërbime të Tjera:**
 - Mundësia për të integruar sistemin me shërbime të tjera cloud për analiza të avancuara, inteligjencë artificiale dhe mjetet e monitorimit dhe logimit.
- **Marrja e Kopjeve Rezervë dhe Rikuperimi nga Fatkeqësitë:**
 - Implementimi i strategjive të kopjeve rezervë automatike dhe planeve të rikuperimit nga fatkeqësitë (Disaster Recovery), për të siguruar integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave.
- **Përputhshmëria me Standardet dhe Rregulloret:**

- Sigurimi që infrastruktura cloud të jetë në përputhje me standarde ndërkombëtare si ISO 27001, SOC 2, dhe kërkesat ligjore lokale për mbrojtjen e të dhënave.
- **Monitorimi dhe Menaxhimi i Infrastrukturës:**
 - Përdorimi i mjeteve të avancuara për monitorimin e performancës, gjëndjes së sistemit dhe identifikimin e anomalive.
 - Alertet në kohë reale dhe raportet e detajuara për të mundësuar reagim të shpejtë ndaj çdo problemi.

Përdorimi i një infrastrukture cloud do të lejojë institucionin të përfitojë nga avantazhet e teknologjive më të fundit, të reduktojë kostot operative dhe të përmirësojë eficiencën në menaxhimin e sistemit.

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MENAXHIMIT TË APLIKACIONIT / SISTEMIT / MODULIT

6.1 Specifikimet Teknike të Menaxhimit të Aplikacionit/Sistemit/Modulit

Për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm, të sigurt dhe të pandërprerë të sistemit elektronik të menaxhimit të proceseve të punës, janë përcaktuar kërkesat dhe përgjegjësitë e mëposhtme, të cilat janë thelbësore për ofruesin e shërbimit:

1. Menaxhimi i Incidenteve

Menaxhimi efektiv i incidenteve është kyç për të minimizuar ndikimin e ndërprerjeve të shërbimit dhe për të rikthyer sa më shpejt funksionalitetin normal të sistemit.

- **Raportimi i Incidenteve:**
 - Institucioni do të raportojë incidentet përmes një sistemi të dedikuar të menaxhimit të shërbimeve IT si p.sh., një portal online, email të dedikuar ose numër telefoni.
 - Incidentet do të kategorizohen sipas nivelit të prioritetit (P1 - Kritike, P2 - Lartë, P3 - Mesatare, P4 - E Ulët) bazuar në ndikimin dhe urgjencën e tyre.
- **Përgjigja ndaj Incidenteve:**
 - **Reagimi Fillestar:** Ofruesi i shërbimit duhet të konfirmojë marrjen e njoftimit për incidentin brenda kohës së përcaktuar në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit.
 - **Ndërhyrja Teknike:** Fillimi i menjëhershëm i punës për identifikimin dhe zgjidhjen e incidentit, duke përdorur metoda dhe mjete të avancuara diagnostikuese.
 - **Komunikimi i Vazhdushëm:** Informimi periodik i institucionit mbi progresin e zgjidhjes së incidentit, me raportime në intervale të rregullta.
- **Zgjidhja e Incidenteve:**
 - **Rikthimi i Shërbimit:** Implementimi i veprimeve korrigjuese për të rikthyer funksionalitetin normal të sistemit sa më shpejt të jetë e mundur.
 - **Dokumentimi i Incidenteve:** Regjistrimi i detajuar i çdo incidenti, duke përfshirë datën dhe kohën e ndodhjes, shkakun rrënjësor,

veprimet e ndërmarra dhe kohën e zgjidhjes.

- **Parandalimi i Incidenteve të Përsëritura:**
 - **Analiza e Shkakut:** Kryerja e analizave për të identifikuar shkaqet themelore të incidenteve dhe rekomandimi i masave parandaluese.

2. Menaxhimi i Problemeve

Qëllimi i menaxhimit të problemeve është identifikimi dhe eliminimi i shkakut rrënjësor të incidenteve për të parandaluar përsëritjen e tyre.

- **Identifikimi i Problemeve:**
 - **Proaktiv:** Monitorimi i vazhdueshëm i sistemit për të identifikuar anomalitë ose trendet që mund të çojnë në probleme të mundshme.
 - **Reaktiv:** Analiza e incidenteve të përsëritura ose të rëndësishme për të zbuluar shkaqet e tyre rrënjësore.
- **Analiza dhe Zgjidhja:**
 - **Diagnoza e Problemeve:** Përdorimi i metodave të avancuara për të analizuar dhe përcaktuar shkakun rrënjësor të problemeve.
 - **Planifikimi i Zgjidhjes:** Hartimi i një plani veprimi për eliminimin e problemit, duke përfshirë veprime korrigjuese dhe parandaluese.
 - **Implementimi:** Zbatimi i planit të zgjidhjes në bashkëpunim me institucionin, duke siguruar që nuk ka ndikim negativ në operacionet e sistemit.
- **Dokumentimi:**
 - Regjistrimi i detajuar i procesit të menaxhimit të problemit, përfshirë analizën, zgjidhjen dhe mësimet e nxjerra për përmirësimin e vazhdueshëm.

3. Menaxhimi i Kërkesave për Shërbim

Menaxhimi i kërkesave për shërbim synon trajtimin efektiv të kërkesave rutinë të përdoruesve që nuk lidhen me incidente ose probleme.

- **Trajtimi i Kërkesave:**
 - **Konfigurimi i Përdoruesve:**
 - Krijimi, modifikimi ose fshirja e llogarive të përdoruesve në sistem sipas kërkesave të institucionit.
 - Menaxhimi i të drejtave dhe privilegjeve të aksesit bazuar në rolet dhe përgjegjësitë.
 - **Ndryshimet në Strukturën Organizative:**
 - Reflektimi i ndryshimeve organizative në sistem, si krijimi i departamenteve të reja, ndryshimi i strukturës së hierarkisë, etj.
 - **Raporte dhe Statistikë:**
 - Gjenerimi i raporteve specifike ose të personalizuara sipas kërkesave të menaxhmentit, duke përdorur mjetet e integruara të analitikës.
 - **Konsulencë dhe Rekomandime:**
 - Ofrimi i këshillave teknike dhe rekomandimeve për

optimizimin e përdorimit të sistemit dhe përmirësimin e proceseve të punës.

- **Koha e Përgjigjes dhe Zgjidhjes:**
 - Respektimi i afateve të përcaktuara për përgjigjen dhe zgjidhjen e kërkesave, duke siguruar shërbim të shpejtë dhe efikas.

4. Menaxhimi i Veprimeve Parandaluese për Sigurimin e Vazhdueshmërisë së Shërbimeve

Veprimet parandaluese janë kritike për të siguruar që sistemi funksionon në mënyrë optimale dhe për të shmangur ndërprerjet e papritura.

a. Monitorim i Vazhdueshëm i Infrastrukturës së Sistemit

- **Monitorim i Performancës:**
 - Përdorimi i mjeteve të avancuara për të monitoruar metrikat kryesore të performancës (CPU, RAM, disk, rrjet) të serverëve dhe shërbimeve në cloud.
 - Vendosja e alarmeve për tejkalimin e pragjeve kritike të resurseve.
- **Monitorim i Aplikacionit:**
 - Vëzhgimi i shërbimeve të aplikacionit për të siguruar funksionimin korrekt të tyre.
 - Kontrolli i disponueshmërisë së aplikacionit dhe kohës së përgjigjes.
- **Monitorim i Sigurisë:**
 - Detektimi i aktiviteteve të dyshimta ose të paautorizuara në sistem.
 - Përdorimi i shërbimeve të sigurisë për identifikimin e kërcënimeve.

b. Monitorimi Periodik i Aktivitetit të Përdoruesve

- **Raporte të Aktivitetit:**
 - Gjenerimi i raporteve periodike mbi aktivitetin e përdoruesve, duke përfshirë:
 - Numrin e përdoruesve aktivë.
 - Numrin e shkresave të procesuara.
 - Datën dhe kohën e fundit të aksesit.
- **Analiza e Tendencave:**
 - Vlerësimi i trendëve të përdorimit për të identifikuar mundësitë për përmirësim ose nevojën për trajnime shtesë.

c. Testime Periodike të Performancës së Sistemit (Nivel Aplikacioni)

- **Testime të Ngarkesës dhe Performancës:**
 - Kryerja e testeve për të vlerësuar sjelljen e sistemit nën ngarkesa të ndryshme.
 - Identifikimi i pikave të dobëta dhe propozimi i masave për optimizim.
- **Optimizimi i Kodit dhe Arkitekturës:**
 - Rishikimi i kodit të aplikacionit dhe arkitekturës për të përmirësuar

efikasitetin dhe performancën.

d. Testime Periodike të Sigurisë së Sistemit (Nivel Aplikacioni)

- **Vlerësimi i Vulnerabiliteteve:**
 - Kryerja e skanimeve të rregullta për të identifikuar dobësitë e mundshme në aplikacion.
 - Përdorimi i mjeteve të certifikuara për testimin e sigurisë.
- **Testime të Penetrimit:**
 - Simulimi i sulmeve për të vlerësuar rezistencën e sistemit ndaj kërcënimeve kibernetike.
- **Përditësimet e Sigurisë:**
 - Aplikimi i patch-eve dhe përditësimeve të sigurisë në kohë për të adresuar dobësitë e identifikuara.

e. Mbështetje në Rast të Ndikimeve të Faktorëve të Brendshëm ose të Jashtëm

- **Planifikimi i Vazhdueshmërisë së Biznesit:**
 - Hartimi dhe mirëmbajtja e planeve për vazhdimësinë e biznesit në rast të ndërprerjeve të papritura.
- **Rikuperimi nga Fatkeqësitë (Disaster Recovery):**
 - Implementimi i strategjive të rikuperimit, snapshot-e të rregullta dhe replikim të të dhënave.
- **Komunikimi Efektiv:**
 - Njoftimi i menjëhershëm i institucionit për çdo ngjarje që mund të ndikojë në shërbim.
 - Sigurimi i informacionit të vazhdueshëm mbi progresin e zgjidhjes.

6.2 Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes për Infrastrukturën Cloud

Duke qenë se infrastruktura e sistemit do jete e hostuar në cloud, ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë mirëmbajtjen dhe administrimin e saj për të garantuar stabilitetin, sigurinë dhe disponueshmërinë e shërbimit.

1. Shërbimi i Mirëmbajtjes për Infrastrukturën Cloud

- **Konfigurimi dhe Skalimi i Resurseve:**
 - Menaxhimi i instancave të serverëve virtualë, ruajtjes së të dhënave dhe shërbimeve të tjera cloud, duke siguruar që ato plotësojnë kërkesat e sistemit.
 - Përdorimi i auto-skalimit për të përshtatur automatikisht resurseve bazuar në ngarkesën e sistemit.
- **Menaxhimi i Rrjetit dhe Sigurisë:**
 - Konfigurimi i Virtual Private Cloud (VPC), nënrrjeteve, tabelave të rrugëve dhe grupeve të sigurisë për të kontrolluar trafikun hyrës dhe dalës.
 - Implementimi i politikave të menaxhimit të identiteteve dhe aksesit (IAM) për të kontrolluar aksesin në resurse.

2. Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemeve Operative dhe Platformave

- **Sistemet Operative të Serverëve Virtualë:**
 - Përditësimi i rregullt i sistemeve operative (p.sh., Linux Server, Windows Server) me patch-e të sigurisë dhe përmirësime të performancës.
- **Përditësimi i Komponentëve të Aplikacionit:**
 - Sigurimi që të gjitha komponentët e aplikacionit (p.sh., serverët web, framework-et) janë në versionet më të fundit dhe të mbështetura.

3. Monitorimi dhe Analiza e Logeve

- **Centralizimi i Logeve:**
 - Përdorimi i shërbimeve për të mbledhur dhe analizuar loget nga të gjitha komponentët e sistemit.
- **Analiza dhe Alarmet:**
 - Vendosja e alarmëve për ngjarje kritike dhe përdorimi i analizës së logjeve për të identifikuar dhe adresuar çështjet potenciale.

4. Sigurimi i Disponueshmërisë dhe Redundancës

- **Arkitectura e Disponueshmërisë së Lartë:**
 - Përdorimi i balancuesve të ngarkesës (Elastic Load Balancing) dhe vendosja e resurseve në zona të shumta të disponueshmërisë (Availability Zones).
- **Backup dhe Rikuperim:**
 - Konfigurimi i backup-eve automatike të të dhënave dhe testimi periodik i proceseve të rikuperimit.

5. Menaxhimi i Kostove

- **Optimizimi i Shpenzimeve:**
 - Monitorimi i përdorimit të resurseve dhe identifikimi i mundësive për optimizim të kostove, si rezervimi i instancave ose përdorimi i instancave spot.
- **Raportimi i Kostove:**
 - Ofrimi i raporteve të detajuara mbi shpenzimet e infrastrukturës cloud dhe rekomandimi i masave për optimizim financiar.

6. Përputhshmëria me Standardet dhe Rregulloret

- **Zbatimi i Politikave të Sigurisë dhe Përputhshmërisë:**
 - Sigurimi që infrastruktura cloud është në përputhje me standarde dhe rregullore relevante, si ISO 27001, GDPR, HIPAA, etj.
- **Auditimet e Sigurisë:**
 - Kryerja e auditimeve periodike për të siguruar përputhshmërinë dhe identifikimin e zonave për përmirësim.

6.2 Specifikimet Teknike për Përditësim, Përmirësim apo Modifikim të Aplikacionit.

A. Përmirësime të sistemit/aplikacionit/modulit

Azhornime të sistemit në aspektin e sigurisë (*dhe jo vetëm*) në rastet kur rregullore të reja hyjnë në fuqi apo funksionalitete të tjera kërkohen nga Autoriteti Kontraktor. Pa kosto shtesë do të jenë, ndryshime në rrjedhën e procesit të menaxhimit të dokumentave që bëhen të nevojshme nga ndryshimet ligjore apo të rregulloreve në fuqi, upgrade të domosdoshme të teknologjisë në përdorim në rastet kur teknologjitë e përdorura nuk janë më në suportin e prodhuesve të tyre, si dhe integritet me sisteme të tjera, në rast se do të paraqitet nevoja.

B. Shërbime të konsulencës

1. Asistencë për stafin teknik të institucioneve në analizën e të dhënave, procedurat e backup-it, dhe raportimin e performacës.
2. Asistencë teknike për problemet e lidhura me komunikimin me sisteme apo komponentë të infrastrukturës.

7. PËRGJIGJIA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Ky seksion përcakton mënyrën e menaxhimit të incidenteve dhe kërkesave për shërbim, duke përfshirë kategorizimin e seriozitetit të problemeve, kohën e përgjigjes dhe zgjidhjes, si dhe procedurat e shkallëzimit. Kjo siguron që shërbimet të ofrohen në mënyrë efektive dhe efikase, duke minimizuar ndërprerjet dhe duke garantuar vazhdimësinë e operacioneve të institucionit.

7.1. Kategorizimi i Incidenteve dhe Nivelet e Shërbimit

Incidenteve dhe problemeve do t'u caktohen kategori bazuar në ndikimin e tyre në aktivitetet e institucionit dhe urgjencën e zgjidhjes. Kategorizimi i incidenteve është si më poshtë:

Kategoria A (Kritik/I Lartë)

- **Ndikimi në Aktivitetin Normal:**
 - Mosfunksionimi i aplikacionit krijon ose rrezikon në mënyrë kritike aktivitetin normal të institucionit.
- **Numri i Përdoruesve të Ndikuar:**
 - Mosfunksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve ose funksione kritike.
- **Pezullimi i Punës:**
 - Përdoruesit janë të pamundur të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre, duke ndikuar ndjeshëm në operacionet e biznesit.
- **Zgjidhje Alternative e Përkohshme:**
 - Nuk ekziston një mënyrë alternative e pranueshme dhe e përkohshme për zgjidhjen e problemit.

Kategoria B (I Mesëm)

- **Ndikimi në Aktivitetin Normal:**

- Mosfzionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal të institucionit.
- **Numri i Përdoruesve të Ndikuar:**
 - Mosfzionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve ose funksione jo-kritike.
- **Pezullimi i Punës:**
 - Përdoruesit janë të pamundur të realizojnë pjesë të caktuara të punës së tyre, por aktiviteti mund të vazhdojë pjesërisht.
- **Zgjidhje Alternative e Përkohshme:**
 - Ekziston pjesërisht një mënyrë alternative e pranueshme dhe e përkohshme për zgjidhjen e problemit.

Kategoria C (I Ulët)

- **Ndikimi në Aktivitetin Normal:**
 - Mosfzionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimale aktivitetin e institucionit.
- **Numri i Përdoruesve të Ndikuar:**
 - Mosfzionimi i sistemit ndikon pjesërisht disa përdorues ose funksione sekondare.
- **Pezullimi i Punës:**
 - Përdoruesit janë të pamundur të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre, pa ndikuar ndjeshëm në operacionet e përgjithshme.
- **Zgjidhje Alternative e Përkohshme:**
 - Ekziston një mënyrë alternative e pranueshme dhe e përkohshme për zgjidhjen e problemit.

7.2. Koha e Përgjigjes dhe Zgjidhjes

Për secilën kategori incidenti, përcaktohen kohët maksimale të përgjigjes dhe zgjidhjes si më poshtë:

Parametri	Kategoria A (Kritik/I Lartë)	Kategoria B (I Mesëm)	Kategoria C (I Ulët)
Koha e Përgjigjes	- 10 minuta për të kthyer përgjigje	- 30 minuta për të kthyer përgjigje	- 60 minuta për të kthyer përgjigje
	- Ndërhyrje brenda 1 ore	- Ndërhyrje brenda 2 orëve	- Ndërhyrje brenda 4 orëve
Koha e Zgjidhjes	Maksimumi 4 orë pas njoftimit	Maksimumi 2 ditë pune	Maksimumi 10 ditë kalendarike

Shënime:

- **Koha e Përgjigjes:** Koha maksimale brenda së cilës Ofruesi i Shërbimit duhet të konfirmojë marrjen e njoftimit dhe të fillojë trajtimin e incidentit.
- **Koha e Zgjidhjes:** Koha maksimale brenda së cilës incidenti duhet të zgjidhet plotësisht.

7.3. Procedurat e Menaxhimit të Incidenteve

- **Raportimi i Incidenteve:** Institucioni do të raportojë incidentet përmes kanaleve të përcaktuara, si emaili i dedikuar, telefoni ose sistemi i menaxhimit të shërbimeve.
- **Kategorizimi dhe Prioritizimi:** Ofruesi i Shërbimit do të vlerësojë incidentin dhe do ta kategorizojë sipas tabelës së mësipërme, duke caktuar prioritetin e duhur.
- **Përgjigja Fillestare:** Ofruesi i Shërbimit do të konfirmojë marrjen e njoftimit brenda kohës së përgjigjes së përcaktuar dhe do të informojë Institucionin për veprimet e planifikuara.
- **Zgjidhja e Incidentit:** Ofruesi i Shërbimit do të punojë në mënyrë proaktive për të zgjidhur incidentin brenda kohës së zgjidhjes së përcaktuar, duke përdorur burimet dhe ekspertizën e nevojshme.
- **Shkallëzimi i Incidentit:** Nëse incidenti nuk mund të zgjidhet brenda afateve të përcaktuara, ai do të shkallëzohet në nivele më të larta menaxheriale, sipas procedurave të përcaktuara të shkallëzimit.

7.4. Menaxhimi i Problemeve

- **Identifikimi i Problemeve Themelore:** Ofruesi i Shërbimit do të analizojë incidentet për të identifikuar probleme të përsëritura ose shkaqe rrënjësore.
- **Planifikimi i Zgjidhjeve Afatgjata:** Për probleme komplekse, do të hartohet një plan veprimi për eliminimin e shkaqeve rrënjësore dhe parandalimin e incidenteve të ardhshme.
- **Dokumentimi dhe Komunikimi:** Të gjitha problemet dhe zgjidhjet e tyre do të dokumentohen dhe do të komunikohen me Institucionin.

7.5. Menaxhimi i Kërkesave për Shërbim

- **Trajtimi i Kërkesave:** Kërkesat për konfigurime, ndryshime, raporte ose konsulencë do të trajtohen sipas prioritetit të tyre dhe do të zgjidhen brenda afateve të përcaktuara.
- **Koha e Përgjigjes dhe Zgjidhjes:**
 - **Kërkesa Kritike:** Përgjigje brenda 1 ore, zgjidhje brenda 8 orëve të punës.
 - **Kërkesa Standarde:** Përgjigje brenda 4 orëve të punës, zgjidhje brenda 3 ditëve të punës.
 - **Kërkesa me Prioritet të Ulët:** Përgjigje brenda 1 ditë pune, zgjidhje brenda 5 ditëve të punës.
- **Ndjekja dhe Raportimi:** Të gjitha kërkesat do të regjistrohen në sistemin e menaxhimit të shërbimeve dhe do të monitorohen deri në zgjidhjen e tyre.

7.6. Veprimet Parandaluese për Sigurimin e Vazhdueshmërisë së Shërbimeve

- **Monitorimi Proaktiv:**
 - **Infrastruktura e Sistemit:** Monitorim i vazhdueshëm i resurseve të sistemit (CPU, RAM, hapësira disk, rrjeti) për të identifikuar dhe adresuar problemet potenciale.
 - **Shërbimet Aplikative:** Monitorim i performancës së aplikacionit dhe shërbimeve të tij për të siguruar funksionimin optimal.
- **Raportet Periodike:**
 - **Aktiviteti i Përdoruesve:** Raporte mujore që përfshijnë numrin e përdoruesve aktivë, numrin e shkresave të procesuara, datën e fundit të aksesit, etj.
 - **Performanca e Sistemit:** Raporte mbi performancën dhe ngarkesën e sistemit, me rekomandime për optimizim.
- **Testime Periodike:**
 - **Testime të Performancës:** Kryerja e testeve për të vlerësuar shkallëzueshmërinë dhe përgjigjen e sistemit nën ngarkesa të ndryshme.
 - **Testime të Sigurisë:** Skanime të sigurisë dhe testime të penetrimit për të identifikuar dhe adresuar dobësitë e mundshme.
- **Suport në Rast të Faktorëve të Jashtëm:**
 - **Planifikimi i Rikuperimit:** Hartimi i planeve të rikuperimit në rast të fatkeqësive ose sulmeve kibernetike.
 - **Ndërhyrje e Shpejtë:** Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë ndërhyrje të menjëhershme në rast se faktorë të jashtëm ndikojnë sistemin.

7.7. Specifikimet Teknike të Mirëmbajtjes për Infrastrukturën Cloud

- **Mirëmbajtja e Sistemeve Operative dhe Databazave:**
 - **Përditësime dhe Patch-e:** Aplikimi i përditësimeve dhe patch-eve të sigurisë në sistemet operative dhe databaza për të garantuar stabilitetin dhe sigurinë.
 - **Monitorimi i Logjeve:** Analizimi i logjeve të sistemit për të identifikuar anomalitë ose aktivitetet e dyshimta.
- **Menaxhimi i Infrastrukturës Cloud:**
 - **Skalueshmëria:** Përdorimi i mekanizmave të auto-skalimit për të përshtatur resurseve sipas kërkesës.
 - **Redundanca dhe Disponueshmëria e Lartë:** Implementimi i arkitekturave të disponueshmërisë së lartë për të minimizuar ndërprerjet.
- **Siguria dhe Përputhshmëria:**
 - **Kontrolle të Sigurisë:** Përdorimi i politikave të kontrollit të aksesit, enkriptimit të të dhënave dhe firewall-eve për të mbrojtur sistemin.
 - **Përputhshmëria me Standardet:** Sigurimi që infrastruktura dhe aplikacioni janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi.

7.8. Procesi i Shkallëzimit të Shërbimit

Në rast se incidentet nuk zgjidhen brenda kohëve të përcaktuara, procesi i shkallëzimit do të jetë si më poshtë:

- **Niveli 1:** Ekipi Teknik i Ofruesit të Shërbimit
 - Kohë për zgjidhje sipas kategorisë së incidentit.
- **Niveli 2:** Menaxheri i Shërbimit
 - Nëse incidenti nuk zgjidhet në Nivelin 1, shkallëzohet tek Menaxheri i Shërbimit për ndërhyrje dhe alokim burimesh shtesë.
- **Niveli 3:** Drejtori Teknik
 - Për incidente kritike ose të pazgjidhura, shkallëzimi bëhet tek Drejtori Teknik për vendimmarrje strategjike.
- **Niveli 4:** Komiteti i Përbashkët i Menaxhimit
 - Në raste ekstreme, incidenti diskutohet në komitetin e përbashkët midis Institucionit dhe Ofruesit të Shërbimit për zgjidhje.

7.9. Indikatorët e Performancës së Shërbimit (KPI)

Për të siguruar një shërbim të cilësisë së lartë, do të monitorohen indikatorët e mëposhtëm:

- **Përqindja e Incidenteve të Zgjidhura brenda Afatit:** Objektivi minimal është 95% e incidenteve të zgjidhura brenda kohës së përcaktuar.
- **Kënaqësia e Përdoruesve:** Vlerësimi periodik i kënaqësisë së përdoruesve përmes sondazheve dhe feedback-ut.
- **Disponueshmëria e Sistemit:** Objektivi minimal i disponueshmërisë është 99%, duke përjashtuar kohën e planifikuar për mirëmbajtje.

7.10. Penalitetet për Mosrespektim të Niveleve të Shërbimit

Nëse Ofruesi i Shërbimit nuk arrin të përmbushë nivelet e shërbimit të përcaktuara, Institucioni rezervon të drejtën të aplikojë penalitete sipas kushteve të kontratës dhe legjislacionit në fuqi. Penalitetet do të përcaktohen në mënyrë të tillë që të inkurajojnë përmbushjen e standardeve të cilësisë.

7.11. Përmirësimi i Vazhdueshëm i Shërbimit

- **Rishikime Periodike:** Do të zhvillohen takime periodike midis Institucionit dhe Ofruesit të Shërbimit për të diskutuar performancën dhe mundësitë për përmirësim.
- **Azhornime Teknologjike:** Ofruesi i Shërbimit do të propozojë dhe implementojë azhornime teknologjike për të përmirësuar performancën dhe sigurinë.
- **Trajnime dhe Edukim:** Ofrimi i trajnimeve për stafin e Institucionit në përdorimin optimal të sistemit dhe adoptimin e praktikave më të mira.

7.12. Dispozita të Tjera

- **Konfidencialiteti dhe Privatësia:** Të gjitha të dhënat dhe informacionet e marra gjatë ofrimit të shërbimit do të trajtohen me konfidencialitet të plotë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.
- **Dokumentimi i Shërbimit:** Ofruesi i Shërbimit do të mbajë dokumentacion të plotë për të gjitha aktivitetet e mirëmbajtjes, incidentet dhe kërkesat, duke siguruar gjurmueshmëri dhe mundësi auditimi.
- **Bashkëpunimi:** Të dy palët do të bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar suksesin e shërbimit dhe përmbushjen e objektivave të përbashkëta.

8.PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Në këtë paragraf është planifikuar buxheti për të gjithë komponentët e sistemit që do ndërtohet si dhe për trajnimet e nevojshme të përdoruesve.

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Analiza e strukturës dhe proceseve të punës	1		
2.	Zhvillimi dhe Implementimi i Sistemit	1		
3.	Trajnimi i përdoruesve	2 javë		
4.	Mirëmbajtja e sistemit	24 muaj		
TOTALI PA TVSH (LEKË)				

9. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Në këtë seksion janë listuar të gjitha fazat e projektit, sipas afatit kohor përkatës i shprehur në muaj:

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	Afati i Shprehur në Muaj					
		M1	M2	M3	M4	M5	24 Muaj
1.	Faza I – Kryerja e analizës së detajuar të strukturës organizative						

	dhe proceseve ekzistuese të punës.		
2.	Faza II - Faza e zhvillimit dhe implementimit të sistemit.		
3.	Faza III - Faza e testimit të sistemit/platformës.		
4.	Faza IV - Trajnimi i përdoruesve.		
5.	Faza V - Marrja në dorëzim e sistemit dhe akordimi për mënyrën e komunikimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes.		
6	Faza VI - Mirëmbajtja e sistemit për periudhën 24 (njëzet e katër) mujore.		

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Dixhitalizimi i proceseve të punës

Detyrat: Bashkelidhur termat e referencës

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Bashkelidhur termat e referencës

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim:

1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuar në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; 696,666.7 (gjashtëqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje shtate)lekë.*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 7.100,87 (shtate mijë e njëqind presje tetëdhjetë e shtate) euro.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës të Shqipërisë datë 14.11.2024 është 98.11 euro.

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021,2022,2023) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2024)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.2.4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2024 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate përkatësisht jo më e vogël 13.933,333.2 (trembedhjete milion e nentëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pike dy) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të ofruara.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardeve ndërkombëtare ISO, të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur

nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

a) ISO 9001: Sistem i Menaxhimit të Cilësisë

Certifikata ISO 9001 vërteton angazhimin e operatorit ekonomik ndaj cilësisë së lartë dhe konsistencës në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve. Kjo garanci është vitale për projekte komplekse si implementimi i sistemeve elektronike të menaxhimit të dokumenteve dhe proceseve, duke siguruar një qasje të strukturuar dhe efikase në menaxhimin e projekteve.

b) ISO/IEC 20000-1: Sistem i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit

Certifikata ISO/IEC 20000-1 dëshmon se operatori ekonomik ka një sistem efektiv të menaxhimit të shërbimeve IT, i cili plotëson kërkesat ndërkombëtare për cilësi dhe efikasitet në shërbimet e teknologjisë së informacionit. Kjo siguron që proceset IT janë të dizajnuara, menaxhuara dhe monitoruara për të plotësuar dhe tejkaluar pritshmëritë e shërbimit.

c) ISO/IEC 27001: Sistem i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit

Certifikata ISO/IEC 27001 vërteton se operatori ekonomik mbron informacionin në mënyrë efektive nga rreziqet e sigurisë, duke reduktuar mundësinë e incidenteve dhe duke ofruar një kornizë të qëndrueshme për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe të të dhënave.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ofertues në këtë procedure, secili prej operatoreve ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO të rënditura më lart, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë në akt marrëveshjen midis palëve.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3. Në përputhje me standardet e larta të kërkuara për cilësinë e sistemit elektronik të menaxhimit të dokumenteve dhe proceseve të punës, operatori ekonomik duhet të demonstrojë angazhimin e tij ndaj ekspertizës teknike përmes përfshirjes së stafit të specializuar dhe të certifikuar në ekipin e tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar prej te pakten 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontrates, punonjes të diplomuar në fusha si shkenca kompjuterike, teknologji informacioni, inxhinieri informatike, duke pasur certifikime dhe specializime sipas kërkesave të mëposhtme:

Kërkesat për Stafin Teknik:

Specializimet dhe Certifikimet e Kërkuara:

1 (një) Specialist i Certifikuar në Cilësinë e Softuerit

Siguron zbatimin e praktikave më të mira dhe standardeve më të larta të cilësisë në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e softuerit, duke siguruar që të gjitha fazat e ciklit të zhvillimit të jenë në përputhje me metodologjitë e kontrollit të cilësisë.

1 (një) Specialist i Certifikuar në Sistemet Operative

Kompetencë në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve operative me ekspertizë dhe profesionalizëm të lartë.

1(një) Specialist i Certifikuar në Baza të Dhënash

Njohuri të thella mbi projektimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të bazave të të dhënave, duke garantuar integritetin dhe performancën e lartë.

1 (një) Specialist Certifikuar për Menaxhimin e Infrastrukturave Cloud

Aftësi për të krijuar zgjidhje teknologjike të besueshme, të sigurta dhe të shkallëzueshme në mjedise cloud.

1 (një) Specialist i Certifikuar në Konceptet Bazë të Cloud Computing

Ky certifikim dëshmon një kuptim themelor të koncepteve të cloud computing, shërbimeve të AWS(ose ekuivalent), arkitekturës, sigurisë dhe çmimeve. Ky specialist do të ketë njohuri të përgjithshme në menaxhimin dhe përdorimin e shërbimeve cloud, duke ndihmuar në adoptimin efektiv të teknologjive cloud në projekt dhe në edukimin e ekipit në praktikat më të mira të cloud computing.

1 (një) Specialist i Certifikuar në Zhvillimin e Aplikacioneve Web

(Microsoft Certified Solutions Developer (MCSD) ose ekuivalent)

Ekspertizë në projektimin, zhvillimin dhe menaxhimin e aplikacioneve komplekse web, duke siguruar që zhvillimet të jenë në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet e industrisë.

1 (një) Specialist i Certifikuar në Analizën e të Dhënave (Microsoft Certified: Power BI Data Analyst Associate ose ekuivalent)Kompetencë e lartë në analizën dhe interpretimin e të dhënave, përdorimin e mjeteve analitike të avancuara, dhe gjenerimin e raporteve strategjike.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime të mësipërme.

Dokumentacioni i Kërkuar për Stafin Teknik:

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve të mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- **Diplomën Universitare** përkatëse, për secilin punonjës të kërkuar më lart.

-
- **Kontratën e Punës** përkatëse, për secilin punonjës të kërkuar më lart.
 - **CV Personale**, për secilin punonjës të kërkuar më lart.
 - **Deklaratë për Ekspertët/Specialistët Përgjegjës**, të nënshkruar nga operatori ekonomik.
 - **Certifikatat Përkatëse të Vlefshme**, për secilin punonjës të kërkuar më lart, të lëshuara nga organizma të akredituar nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës.
 - **Listëpagesat Sipër e Sig25** për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, ku të përfshihet stafi i mësipërm, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, Pjesa III, Pika B.

Diplomimi: Të paktën 3 (tre) prej tyre duhet të jene diplomuar në fushën e Teknologjisë së Informacionit, si Inxhinieri Informatike, Shkenca Kompjuterike apo fusha të ngjashme.

Periudha e Angazhimit: Punonjësit duhet të jenë të angazhuar për një periudhë minimale prej 3 (tre) muajsh.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, të gjithë operatorët së bashku duhet të zotërojnë dokumentet e mësipërme, dhe çdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas zërave të shërbimeve që do të ndërmarrë apo realizojë sipas marrëveshjes.

